



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:076457

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 04941925

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.299/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska, me procesmbajtësen Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurve B. N. dhe A. S. , që të dy të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.644/2021 të datës 20.04.2021, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 06.11.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit B. N., të pandehurit A. S. , me mbrojtësin sipas autorizimit av.Veton Berisha, me datë 07.11.2023 shpalli ndërsa me datë 16.11.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

B. N., nga i ati K. dhe e ëma T. e vajzërisë K., i lindur me ..... në Gjakovë, me vendbanim në fsh N. e E. K e Gjakovës, i pa martuar, ka të kryer Fakultetin e Infermierisë, i gjendjes së mirë ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, dhe

A. S. nga i ati D. dhe e ëma H. e vajzërisë J., i lindur me ..... në fsh I. K e Deçanit, ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. .... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLEN FAJTORE

I. Për shkak se i pandehuri B. N. :

Me datë 25.03.2021, rreth orës 13:00 në Qendrën e Paraburgimit në P., në rr. "Sh. B." K. e Pejës, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit A. S. , në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të çastit në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit ky i fundit e sulmon fizikisht të njëjtin, duke e goditur me grushte në fytyrë duke rrëzuar në tokë, ku si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkakton gërvishtje lëkurore të regjonit ballor të kokës dhe të nënsyrit të djathtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës-gërvishtës jo i mprehtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm në shëndet,

- me çka ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën. par 1.4 të KPRK-së.

II. Për shkak se i pandehuri A. S. :

Me datë 25.03.2021, rreth orës 13:01 minutë në Qendrën e Paraburgimit në P., në rr. "Sh. B." K. e Pejës, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit B. N., në atë mënyrë që pasi i dëmtuari e godet të pandehurin me grusht në fytyrë dhe e rrëzon në tokë, ky i fundit pasi që arrin të qohet, sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur disa herë me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasojë e kësaj i dëmtuari pëson Gërvishtje lëkurore të regjionit të gishtit të shuplakës së dorës me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës-gërvishtës (jo i mprehtë-i topitur) dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm në shëndet.

- me çka ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën. par 1.4 të KPRK-së.

Prandaj, në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit B. N. i shqipton:

DËNIM MË GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

II. Të pandehurit A. S. i shqipton:

DËNIM MË GJOBË në lartësi prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

III. Obligohen të dënuarit secili veç e veç, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

IV. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga palët.

## ARSYETIM

A. Historiku i çështjës;

Prokuroria Themelore në Pëjë-Departamenti i Përgjithshëm më datës 20.04.2021 pranë kësaj gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.644/2021 e datës 20.04.2021, kundër të pandehurve B.

N. dhe A. S. për shkak të veprës penale Lendim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata me datës 06.11.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë prezantuan Prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri B. N. dhe i pandehuri A. S. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.Veton Berisha.

Pasi u konstatua që plotësohen kushtet për mbajtjen e seancës, gjykata ftoi prokurorin e shtetit që të lexoj aktakuzën, të cilën të pandehurit e përcjellën me vëmendje dhe deklaruan se e kanë të qartë se me çfarë vepre penale ngarkohen.

Duke u deklaruar në lidhje me akuzën që u vihej në barrë i pandehuri B. N. deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale që i ngarkohet, ndërsa i pandehuri A. S. u deklarua i pafajshëm.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri B. N. deklaroi “Duke marr parasysh se këtu i akuzuari B. N., e pranoi fajësisë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, se pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht pa ndikim apo lajthim dhe në përputhshmëri të plotë me faktet në të cilat mbështet kjo aktakuzë, nga Gjykata kërkojmë që pranimin e fajësisë ta provoj si të tillë.

Gjykata e vlerësoj pranimin e fajësisë në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, dhe vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri B. N..

Në kuptim të nenit 242 par.8 pika 8.1 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të shtyhet shqiptimi i sanksionit penal ndaj të pandehurit B. N. deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në lidhje me të pandehurin A. S. u vazhdua me procedurën e provave.

B. Vendimi lidhur me fajësinë;

Me qenë se i pandehuri B. N. e pranoj fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, procedura e provave në këtë çështje penale u zhvillua vetëm sa i përket pjesës së akuzës që lidhet me të pandehurin A.S..

Prokurori i shtetit përmes aktakuzës dhe në fjalën hyrëse shpreh bindjen se i pandehuri A. S. e ka kryer veprën penale që i ngarkohet dhe se ky pretendim do të vërtetohet me anë të provave të propozuara në aktakuzë me theks të veçantë me CD-në me videoincizimet që paraqesin momentin e përleshjes ndërmjet këtu të pandehurve.

Mbrojtësi i të pandehurit që në hyrje të shqyrtimit gjyqësor, paraqiti pretendimin se veprimet e të mbrojturit të tij janë kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, për çka sipas tij këto veprime nuk përbejnë vepër penale dhe se i pandehuri duhet të shpallët i pafajshëm.

Me qëllim të zbardhjes së të vërtetës dhe vërtetimit të fakteve thelbësore të kësaj çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor u bë administrimi i të gjitha provave të propozuara nga prokurori dhe atë u lexuan dhe shikuan provat si në vijim: Akt ekspertimi mjeko ligjor i dr.V. K. me nr.reference -07/2021 i dt.12.04.2021, Raporti i policit R. P. me nr.rasti 2021-DA-..., Raporti i policit hetues E. S. me nr.rasti 2021-DA-..., Deklarata e pandehurit B. N., e dhënë në Stacionin Policor me t.26.03.2012, Deklarata e pandehurit A. S. e dhënë në Stacion policor me dt.26.03.2021 dhe CD me vidio incizime.

Akt ekspertimi mjeko ligjor i Dr.V.K. me nr.reference -../2021 i dt.12.04.2021, pa mëdyshje vërteton se që të dy të pandehurit kanë pësuar lëndime trupore, përkatësisht në konstatimet përfundimtare të këtij akt ekspertimi thuhet se B. N. dhe A. S. kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

Me anë të kësaj prove vërtetohet njëri nga elementet kryesore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurit, pra është vërtetuar fakti se janë shkaktuar lëndimet e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit.

Raportet e policëve R. P. dhe E. S. kanë përshkruar në detaje rrjedhën e procedurës parapenale dhe veprimet fillestare hetimore të cilat janë marrë me qëllim të zbardhjes së kësaj ngjarje, këto raporte kanë përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën dhe me provat tjera që e mbështesin

aktakuzën edhe pse këto prova për gjykatën nuk kanë ndonjë vlerë të lartë provuese në lidhje me faktet relevante, megjithatë përmes tyre gjykata e ka një pasqyrë të ngjarjes dhe veprimeve hetimore që janë ndërmarrë, gjë që i ndihmon procesit të të provuarit.

Deklarata e pandehurit B. N. e dhënë për hetuesit policor në Q. e P. në P. me dt.26.03.2021, e konfirmon në tërësi gjendjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pra i pandehuri tregon se si ka nisur fjalosja, e cila fjalosje është intensifikuar ku pasi që i pandehuri A. ka tentuar ta godas të pandehurin B., ky i fundit është shmangur dhe e ka goditur me grusht A. i cili është rrëzuar në tokë, ku pastaj është ngritur dhe ka filluar ta godas të pandehurin B. deri sa kanë ndërhyrë të burgosurit e tjerë dhe i kanë ndarë.

Përmes kësaj deklarate vërtetohet në tërësi gjendja faktike e paraqitur si në dispozitiv të aktgjykimit, kjo deklaratë është në përputhje edhe me provat tjera si: Deklarata e të pandehurit A. S. dhe CD-ja me video incizime, të cilat do të trajtohen në vazhdim.

Deklarata e pandehurit A. S. e dhënë në Stacion Policor me dt.26.03.2021, gjithashtu konfirmon në tërësi gjendjen e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, i pandehuri shpjegon se si ka nisur fjalosja, tregon se i pandehuri B. e ka goditur i pari, pastaj ky i është kundërpërgjigjur duke e goditur me grushta.

Kjo deklaratë është në përputhje të plotë me deklaratën e të pandehurit Blerim dhe me provat tjera në të cilat mbështetet ky aktgjykim, ku me anë të kësaj deklarate vërtetohet se të pandehurit e kanë goditur njëri tjetrin, përkatësisht i pandehuri A. personalisht e konfirmon se e ka goditur të pandehurin B., e me këtë vërtetohet njëri nga faktet kryesore të dispozitivit të aktgjykimit, që është veprimi i kryerjes së veprës penale, i cili veprim ka shkaktuar pasojën e parashikuar me vepër penale, që është lëndimi i lehtë trupor.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, u shikua CD-ja me dy video incizime të shënuara si CAM 09 dhe CAM 11, këto dy video u shikuan në tërësi dhe ishin të çastshme për të gjitha palët dhe publikun.

Në videon CAM 09, shihet një hapësirë rekreacioni brenda Q. së P. në P., me disa persona në një hapësirë të vogël gjelbëruese dhe një tabelë ping-pongu, ku nga minuta 01:08 me kohën e videos, përkatësisht 12:59:03 sipas kohës së kamerave shihet ku një person i veshur me rroba të kuqe përkatësisht jelek të kuq dhe pantallona të kuqe sulmon një person të veshur me rroba të

zeza, përkatësisht pantallona të kuq dhe xhemperë të zi, ku në minutën 01:16 të kohës së videos dhe minutën 12:59:12 të kohës së kamerave, rrahja përfundon me ndërhyrjen e disa personave.

Në videon CAM 11, shihet i njëjti ambient si në videon paraprake, ku shihen disa persona duke ecur dy prej tyre duke luajtur ping-pong, kjo video është marrë nga kahu i kundërt i videos paraprake, në kohën 01:48 sipas videos dhe 13:00:49 të kohës së kamerave shihen dy persona që ndalen duke folur në mes veti dhe dy të tjerë që i shikojnë, pastaj shihet një grumbullim i njerëzve ku në minutën 02:12 sipas videos përkatësisht minuta 13:01:13 sipas kamerave një person i veshur me xhamper të zi fillon ta godasë personin përballë tij, i cili shihet se përkulet në gjunjë e pastaj ngrihet një person i veshur me pantallona të kuqe, jelek të kuq dhe xhemper të zi, ku fillon ta godasë personin tjetër në minutën 02:18 sipas videos përkatësisht minutën 13:01:19 sipas kamerave, në video shihet qartazi se personi i veshur me të zeza i merr disa goditje në kokë dhe pjesën e sipërme të trupit, pastaj shihet se rrahja përfundon brenda një kohe të shkurtër me ndërhyrjen e personave të tjerë.

Përmes këtyre vidove incizimeve qartazi arrihet të shihet dhe vërtetohet fakti se në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndodhur një përleshje ndërmjet dy personave, ku fillimisht shihet se personi me bluzë të zezë e godet personin tjetër me jelek të kuq, e pastaj ky i fundit kundërpërgjigjet duke e goditur disa herë të parin.

Ngjarja e paraqitur në këto incizime, përputhet në tërësi me ngjarjen e përshkruar nga dy të pandehurit në deklaratat e tyre të dhëna në fazën e hetimeve, të dy të pandehurit e përshkruajnë përleshjen ashtu siç shihet në incizime, përshkruajnë fillimin e përleshjes me goditjen e dhënë nga i pandehuri B., kundërpërgjigjen e të pandehurit A. duke e grushtuar të pandehurin B. dhe përfundimin e përleshjes me ndërhyrjen e disa personave.

Pra, gjykata erdhi në përfundim se deklaratat e të pandehurve të dhëna në Polici, e vërtetojnë pa mëdyshje faktin se personat që shihen të përleshën në videoincizime, janë pikërisht të pandehurit B. N. dhe A. S. .

I pandehuri A. S. në shqyrtim gjyqësor e dha mbrojtjen e tij me deklaram ku fillimisht konfirmoi se ka dhënë deklaratë në polici me datë 26.03.2021 dhe se mbetet në tërësi pranë asaj deklarate, tutje shtoj se “në ditën kritike është sulmuar nga B. N., i cili e ka goditur një herë me grusht në nofull me ç’rast ky është rrëzuar” tutje shton se “pasi që është ngritur nga toka e ka goditur disa herë me grushta të pandehurin B. N., mirëpo një gjë të tillë e ka bërë në vetëmbrojtje”.

Tutje duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës, i pandehuri A. S. deklaroi se “ngjarja që u pa në videon e shikuar në gjykatë, është e njohur për të dhe se në pjesën ku shihen dy persona duke u përleshur njëri nga ta është vetë i pandehuri A., e pastaj konfirmon se nga personat që shihen duke u përleshur në video incizim, i pandehuri A. është personi i veshur me jelek të kuq”.

Pra, i pandehuri A. S. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor edhe njëherë e konfirmon deklaratën e dhënë në polici, me çka pa mëdyshje vërtetohet se i njëjti ka qenë i përfshirë në përleshjen me të pandehurin B. N., ku e kanë goditur njëri tjetrin me grushta si në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën është e rëndësishme, se i pandehuri në mbrojtjen e tij e konfirmon se është personi me jelek të kuq që shihet në video incizimin e shikuar në gjykatë, me këtë i heq të gjitha dilemat në lidhje me faktin se a ka qenë i përfshirë në përleshje, përkatësisht përmes mbrojtjes së tij dhe video incizimit pa mëdyshje vërtetohet fakti se i pandehuri A. S. është përfshirë në përleshje dhe e ka goditur disa herë në pjesë të ndryshme të trupit të pandehurin B. N..

Në fjalën përfundimtare, prokuroi i shtetit mbeti në tërësi pranë akuzës duke u shprehur se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është arritur që në tërësi të vërtetohet se i pandehuri A. S. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ku prokurori i numëroj dhe elaboroj në detaje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe që e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit.

Prokurori i shtetit u deklarua edhe në lidhje me pretendimin e mbrojtësit se vepra penale është kryer në gjendje të mbrojtjes së nevojshme, ku prokurori i shtetit theksoi “në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit A. S. nuk janë përmbushur elemente e mbrojtjes së nevojshme e cila në rastet kur konkurren si e tillë përjashton kundërligjshmërinë e së bashku me të edhe përgjegjësinë penale për faktin se mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për ta zmbarsur sulmin e kundërligjshëm real dhe të atë qasshëm ndaj vetës, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut, që paraqet sulmi, e që në rastin konkret i pandehuri A., pasi që goditet nga i dëmtuari duke pranuar vetëm një goditje vazhdon dhe e godet nëntë herë radhazi në pjesë të ndryshme të trupit duke tejkaluar kështu në tërësi mbrojtjen e nevojshme, e kjo për faktin se sidomos në momentin kur i dëmtuari B. bie në tokë, aty pushon së vepruari sulmi dhe rreziku ku edhe pas këtij momenti i pandehuri A. e godet së paku edhe 4-



5 herë të tjera, prandaj qëndrimi i mbrojtjes se në rastin konkret, kemi të bëjmë me mbrojtje të nevojshme është i paqëndrueshëm për shkak të arsyeve të dhëna si më lartë”.

B. N. kur u dëgjua në cilësi të dëmtuarit me veprën penale të kryer nga i pandehuri tjetër, në fjalën përfundimtare deklaroi “Unë fillimisht dua të theksoj se ja bëj hallall dhe e fali këtu të pandehurit A. S. , unë besoj se kjo çka ka ndodhë është e keqe, se na jena tu dashtë me shku te familja jonë, unë jam në gjendje me ja zgjatë dorën dhe me u pajtua, se nuk kam asnjë problem me të dhe shpresoj që kjo të jetë reciproke”.

Mbrojtësi i të pandehurit A. S. , av.Veton Berisha deklaroi “ nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor shihet se në veprimet e të mbrojturit tim konsumohen elementet e mbrojtjes së nevojshme të parapara me nenin 12 par.2 të KPRK-së, i mbrojturi im në mënyrë instiktive i është përgjigjur këtij sulmi për ta zbrapsur nga vetja për çka konsiderojmë se nuk ka kryer veprë penale dhe kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta liroj nga përgjegjësia penale”.

I pandehuri A. S. në fjalën përfundimtare u deklarua se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij.

Gjykata e analizoj me kujdes të shtuar pretendimin e mbrojtjes se në veprimet e të pandehurit A. S. , është konsumuar mbrojtja e nevojshme dhe erdhi në përfundim se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar, për arsyet si në vijim.

Në nenin 12 par.2 të KPRK-së, është dhënë nocioni i mbrojtjes së nevojshme si në vijim “Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi”.

Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme kërkohet që i sulmuari të zbraps sulmin i cili është i kundërligjshëm, real dhe i atëçastshëm, mirëpo në rastin konkret nëse shikohen veprimet e të pandehurit A. S. rezulton se nuk plotësohen këto kushte.

Në video incizim, shihet qartë kur i pandehuri B. N. e godet të pandehurin Avni me grusht në fytyrë ku ky i fundit rrëzohet, pastaj shihet se i pandehuri Blerim largohet nga i pandehuri Avni disa metra, pra nuk e vazhdon sulmin dhe as nuk shihet se ka qëllim të vazhdoj sulmin, pastaj i pandehuri A. ngritet menjëherë në këmbë dhe nis të drejtim të pandehurit B. i cili ishte disa

metra larg tij, ku i pandehuri A.e sulmon me grushte në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit deri sa i pandehuri B. rrëzohet në tokë.

Pra i pandehuri A., ka filluar ta godas të pandehurin B. në momentin kur ky i fundit ishte larguar, pra në atë moment i pandehuri A., nuk ishte duke u sulmuar nga i pandehuri B., sulmi tashme kishte pushur.

Nga kjo rezulton, se veprimet e të pandehurit A. nuk janë ndërmarrë për ta zmbarsur sulmin e të pandehurit B., pasi që sulmi tashmë kishte përfunduar, për më tepër nga video incizimi shihet se i pandehuri A. e godet të pandehurin B. edhe pasi që ky i fundit kërryset dhe rrëzohet në tokë.

Në këtë rast nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë as me tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, pasi që tejkalimi vjen në shprehje kur mbrojtja është kryer në të njëjtën kohë me sulmin, mirëpo e njëjta është në disproporcion me sulmin, për nga mënyra dhe mjeti i përdorur gjatë zmbarsjes së sulmit.

Në rastin e të pandehurit A. S. “zmbarsja e pretenduar e sulmit” është ndërmarrë pasi që tashmë sulmi kishte përfunduar, e në anën tjetër pa pikë dyshimi mund të thuhet se në këtë rast ka pasur edhe disproporcion të veprimeve sulmuese, pasi që i pandehuri B. e ka goditur njëherë të pandehurin A.dhe është larguar (e ka pushur sulmin), ndërsa i pandehuri A.e ka goditur disa herë të pandehurin B. dhe nuk është ndaluar deri sa kanë ndërhyrë persona të tjerë për ti ndarë.

Gjykata erdhi në përfundim se me provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor dhe të trajtuara si më lartë është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se i pandehuri A. S. me dashje e ka sulmuar të pandehurin-të dëmtuarin B. N., të cilin e ka goditur disa herë me grushta në fytyrë dhe në pjesën e sipërme të trupit, me të cilat goditje të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin, e me këto veprime e ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

C. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë të pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurve vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë, për të pandehurin B. N. në lartësi prej 500 (pesëqind) euro ndërsa për të pandehurin A. S. në lartësi prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim detyrohen ta paguajnë të dënuarit secili veç e veç, në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast se të pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet dhe rrethanat e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit nuk kemi fare rrethana rënduese, ndërsa rrethana lehtësuese gjykata gjeti vetëm në lidhje me të pandehurin B. N., e që janë pranimi i fajësisë i bërë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku edhe shprehi gatishmërinë që ti zgjas dorën të pandehurit tjetër dhe të pajtohen në gjykatë, e duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së, gjykata vendosi që ndaj të pandehurve të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin me gjobë gjykata e shqiptoi duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurit, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurve t'u shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata shqiptoj dënim me gjobë më të lartë për të pandehurin A. S., kjo për faktin se në lidhje me të njëjtin nuk gjeti fare rrethana lehtësuese, ndërsa për të pandehurin B. N. gjeti rrethanat lehtësuese të përshkruara si me lartë, të cilat rrethana edhe ndikuan në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga të pandehurit.

D. Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike;

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor është marrë, në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Meqenëse palët nuk paraqitën kërkesë pasurore juridike, gjykata as nuk vendosi për të njëjtët e as nuk i udhëzoi palët në kontest civil.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.299/21, me datë 16.11.2023

Procesmbajtësja

Gjyqtari i vetem gjykues

Shpresa Kërnja

Leon Përlaska

## KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë, në afat prej 30 ditësh nga momenti pranimi të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.